

6.1 LLAÇRA PËR SUVATIME

MORTEL GP-10



| Njësia matëse | Copë/paletë | Konsumi | Ngjyra/specifikime të tjera |
|------------------------------|------------------------|---------------------------------|-----------------------------|
| 30 kg/thes 100 Kg/Rifuxho | 72 cp/paletë Sillos | 1,5 Kg/m ² /mm -- | Gri -- |



MORTEL GP-10

Material mbushës themelor për mure tulle ose blloku për ambiente te brendshme ose të jashtme.

KAREKTERISTIKAT TEKNIKE

Material në formë pluhuri me bazë: çimento, gëlqere, rëre guri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditiv special.

- Karakterizohet nga një punueshmëri mjaft e mirë.
- Rezistencë të lartë mekanike
- Pa rrëshqitshmëri vertikale
- Aftësi ngjitëse në mure dhe tavane.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret si llaç themelor për suvatimin e të gjitha llojeve të suporteve si mureve prej tulle, blloku etj. Produkti aplikohet me makineri ose me dorë. Gjatë aplikimit të produktit temperatura e suportit dhe temperatura e ambientit duhet të jenë nga +5°C deri në +35°C.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet materiali duhet të jetë i thatë, i pastër, i njëtrajtshëm, absorbues, i qëndrueshëm. Nuk duhet të ketë mbetje të huaja si vajra, verniqe, naftë, etj. Suporti mbi të cilin aplikohet materiali nuk duhet të ketë shfaqje dukurish të tilla si efluoshenca.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieni 25 Kg pluhur Llaç Mbushës me 6.5 - 7 litra ujë me anë të një përzierësi elektrik ose në mënyrë manuale, derisa të fitohet një masë për punueshmërinë e kërkuar. Mund të punohet edhe me pompë.

MËNYRA E APLIKIMIT TE PRODUKTIT

Produkti aplikohet në mënyrë manuale, me mistri ose në mënyrë mekanike me pompë. Kur produkti aplikohet me pompë duhet pasur kujdes konsistenca e përpunimit. Mos e përzieni me materiale të tjera përveç Latex. Në rast pauzash më të gjata, përzierësi duhet të lihet bosh dhe të pastrohet. Llaçi i freskët duhet përpunuar brenda 2 orëve. Mbroni tullat dhe llaçin (mbi të gjitha gjatë ndërprerjes së punës) nga shiu. Në rast se temperaturat janë të larta mirë është që llaçi të laget pak përpara se të thahet në mënyrë që të mos humbasë ujin.

PËRFORCIMI ME LATEX

Për t'i përmirësuar ngjitshmërinë, papërshkueshmërinë nga uji, plasticitetin, elasticitetin, forcën mekanike etj, llaçi mund të përforcohet me adetivin LATEX. Raporti i përzierjes është 1:5 në ujë.



TË DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

| | |
|--------------------------------------|--|
| Forma | Pluhur |
| Ngjyra | Gri |
| Ruajtja | 12 muaj në paketim original në vënd të thatë |
| Djegshmëria | I padjegshëm |
| Raporti i përzierjes | 6 - 6.5 litra ujë për 25 Kg llaç murature |
| Dendësia e përzierjes | 1.9 gr/cm ³ |
| Konsistenca e përzierjes | Tiksotropike |
| Temperatura e aplikimit | +5°C deri në +35°C |
| Kohëzgjatja e përzierjes | 3 - 4 orë |
| Koha e punueshmërisë | 30 min |
| Trashësia maksimale për dorë | 1.5 cm |
| Rezistenca ne shtypje pas 7 - ditëve | ≥ 3. 5 N/mm ² |
| Përçueshmëria termike | sipas EN 1745 0,28 W/mK |
| Fillimi i ngurtësimit | 385 min |

TË DHËNA PËRFUNDIMTARE

| | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| Rezistenca në shtypje pas 7-ditëve | ≥ 3.5 N/mm ² |
| Rezistenca në shtypje pas 28-ditëve | ≥ 5 N/mm ² |
| Rezistenca ndaj kripërave | E mirë |

